



Npi – 01/250 datë: 27.06.2023

Bazuar në nenin 12.2 shkronja (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008); Nenin 11, 13 dhe 14.3 shkronja (d) të Ligjit Nr.02/L-26 për Tokën Bujqësore, si dhe duke marrë për bazë edhe Planin Rregullues Urban 2009-2020 (Zona M, Blloku M7 – ku është e definuar si hapsirë për banim dhe afarizëm) Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, me Rekomandimin Nr.06/97 më datën 27.06.2023 i ka propozuar Kuvendit miratimin e vendimit për Destinimin e N.K. Nr.P-03020-2 me sipërfaqe totale 1788m<sup>2</sup>, Z.K-Shtime, Evidentuar Pronë e Komunës së Shtimes, të destinohet nga prona bujqësore në pronë ndërtimore për banim dhe afarizëm. Kuvendi i Komunës duke shqyrtuar propozimin e Drejtoris për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi në mbledhjen e mbajtur më 27.06.2023, miratoi këtë

## V E N D I M

### **Për ndërrimin e destinimit të Ngastrës Kadastrale Nr.P-03020-2 nga prona bujqësore në pronë ndërtimore**

#### I

**Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -VI- të rregullt për vitin 2023, të mbajtur më 27.06.2023, unanimisht miratimin Vendimin për ndërrimin e destinimit të Ngastrës Kadastrale Nr. P-03020-2, me sipërfaqe totale 1788m<sup>2</sup>, Z.K-Shtime, Evidentuar Pronë e Komunës së Shtimes, që të destinohet nga prona bujqësore në pronë ndërtimore.**

#### II

Arsyetim: Kuvendi i Komunës, ka marrë parasysh edhe rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa Npi-01/241 më datën 23.06.2023 si dhe rekomandimin e Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi Nr.06/97 më datën 27.06.2023 me arsyetimin se ndërrimi i destinimit të tokës bëhet për interes të përgjithshëm, rrugë publike e cila ka shërbyer dhe është në funksion për qytetarë për shumë vite. Propozimi është i bazuar në Ligjin Nr.02/L-26 për Tokën Bujqësore si dhe Planin Rregullues Urban 2009-2020 të Komunës së Shtimes (Zona M, Blloku M7 – ku është e definuar si hapsirë për ndërtim – banim dhe afarizëm)

#### III

Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, është e obliguar që të kryej procedurat tjera administrative dhe Ligjore për implementimin e këtij vendimi.

#### IV

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në MAPL, si dhe publikimi në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

#### V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtoris, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi Kuvendit

Adnan Ademi